

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 47108/08
Alba Games dhe Eduard Biti
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 19 mars 2024, si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

duke marrë në konsideratë:

kërkesën (nr. 47108/08) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 17 shtator 2008, nga Alba Games, një kompani e themeluar në Shqipëri (“kompania kërkuese”), dhe z. Eduard Biti, një shtetas shqiptar, lindur më 1968 dhe banues në Tiranë (“kërkuesi i dytë”), dhe përfaqësuar nga z. Muçi, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të vënë në dijeni në lidhje me kërkesën qeverinë shqiptare (“Qeveria”), fillimisht e përfaqësuar nga agjenti i saj i asaj periudhe A. Hiçka, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

vërejtjet e palëve;

vendimin e datës 31 gusht 2023 për të përjashtuar kërkesën nga lista e saj e çështjeve, për shkak të mungesës së interesit;

vendimin e datës 1 shkurt 2024 për të kthyer kërkesën në listën e saj të çështjeve (rregulla 43 § 5 e Rregullores së Gjykatës), pasi kërkuesi kishte provuar se e kishte ndjekur rregullisht kërkesën;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me legjislacionin për lojërat e fatit, për të cilin pretendohet se ndikonte në aktivitetin e biznesit të kërkuesve.

2. Më 31 dhjetor 2002, kompanisë kërkuese iu akordua një licencë për të operuar pajisje për lojërat e fatit për dhjetë vjet. Në periudhën nga data 19 korrik 2003 deri më 14 mars 2007, kompania kërkuese bleu tetëmbëdhjetë ruleta elektronike, me më shumë se një pozicion për lojëra fati, dhe nga viti 2003 deri në vitin 2008, kompania kërkuese lidhi kontrata qiraje për marrjen me qira të ambienteve në qytete të ndryshme në vend.

3. Më 28 maj 2007, parlamenti ndryshoi ligjin për lojërat e fatit me parashikimin se vetëm makinat e fatit që e jepnin menjëherë çmimin do të lejoheshin si lojëra elektronike të fatit. Licencat u kërkuan brenda gjashtë muajsh që nga hyrja në fuqi e ndryshimeve për heqjen e të gjitha makinave të tjera të fatit, duke përfshirë ruletat me më shumë se një pozicion loje, që nuk përfshiheshin në përkufizimin e ri statutor.

4. Më 10 shtator 2007, Unioni i Bizneseve të Lojërave të Fatit, ku kompania kërkuese ishte anëtare, depozitoi një ankesë kushtetuese ndaj ligjit të vitit 2007, ku kryesisht ankohej për shkeljen e të drejtave ndaj pronës së anëtarëve të tij, për shkelje të së drejtës së anëtarëve të tij për t’iu drejtuar gjykatës dhe për shkelje të parimeve për siguri juridike dhe të drejta të përfutuara.

5. Më 19 mars 2008, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesën kushtetuese të Unionit. Ajo pranoi se përjashtimi i makinave të lojërave me pozicione të ndryshme lojërash nga përkufizimi i ndryshuar për makinat elektronike të lojërave sillte një kufizim në aktivitetin ekonomik të të licencuarve. Me ndryshimin e dispozitës, ligjvënësi ndiqte një sërë interesash publikë, si: rritjen e sigurisë në lojërat e fatit me anë të një kontrolli më strikt ndaj këtij aktiviteti; shtrëngimin e rregullave të licencimit dhe përmirësimin e shpërndarjes gjeografike të licencave; rritjen e të ardhurave të buxhetit të shtetit, duke rritur taksat; kategorizimin dhe ndarjen e lojërave të fatit dhe mbrojtjen më të mirë të të rinjve. Shtimi i një kriteri të ri pa pasur masa përjashtuese apo diskriminuese ndaj të licencuarve të tjerë, nuk mund të konsiderohej jokushtetues, përderisa nuk pengojë thelbi i aktivitetit ekonomik apo nuk ndalohej ushtrimi i tij. Të gjithë të licencuarit mund të merrnin një licencë për të operuar makinat me pozicione të ndryshme lojërash, nëse ata përmbushnin kërkesat statutores. Duke qenë se ky ishte një aktivitet i ri në vend, autoritetet ishin të detyruar të kontrollonin dhe të parandalonin rritjen e varësisë ndaj lojërave të fatit. Për sa u përket faktorëve ekonomikë dhe socialë, ligjvënësi kishte menduar të shtonte një kriter licencimi për ushtrimin e duhur të rolit rregullator të shtetit.

6. Në vijim, Gjykata Kushtetuese gjykoi se dispozita nuk kishte për qëllim, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të shpronësohej prona përkatëse e të licencuarve. Nëse përmbusheshin kriteret statutores, mund të lejohej funksionimi i makinave me pozicione të ndryshme lojërash. U takonte të licencuarve të shisnin, merrnin me qira apo t'i hiqnin këto makina të lojërave të fatit. Gjithashtu, ligjvënësi kishte parashikuar një periudhë gjashtëmujore, gjatë së cilës të licencuarit mund t'i përdornin këto makina, për të shmangur pasoja negative të menjëhershme.

7. Gjithashtu, ajo gjykoi se shoqata nuk kishte vërtetuar dëmin financiar të pakthyeshem që do të shkaktohej nga kufizimi i aktivitetit ekonomik të anëtarëve të saj. Dispozita nuk pretendonte të revokonte plotësisht licencën; ajo kufizonte makinat e lojërave të fatit me më shumë se një pozicion lojërash. Pjesa tjetër e licencës, për sa kishte të bënte me makinat e tjera të lojërave, vijonte të ishte e vlefshme.

LIGJI PËRKATËS VENDËS

A. Kushtetuta e vitit 1998

8. Pjesa përkatëse e Kushtetutës parashikon, si më poshtë:

“Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.

(...)

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundërt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.”.

9. Neni 122 parashikon, se: “një marrëveshje ndërkombëtare, e ratifikuar, përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik...”. Një marrëveshje e tillë ndërkombëtare zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe mbizotëron ndaj legjislacionit të brendshëm me të cilin bie ndesh.

B. Kodi Civil i vitit 1994

10. Pjesa përkatëse e Kodit Civil parashikon, si më poshtë:

“Neni 190

Prona mund të shpronësohet vetëm për interesa publikë të njohur me ligj dhe vetëm kundërt një shpërblimi të drejtë.

(...)”.

C. Ligji nr. 8510 i datës 15 korrik 1999 për përgjegjësinë jokontraktuale të institucioneve të administratës shtetërore

11. Nenet 1 dhe 3 të atij ligji (ndryshuar me ligjin nr. 10005 të datës 23 tetor 2008) parashikojnë se shteti është përgjegjës për dëmin pasuror dhe jopasuror jokontraktual, shkaktuar ndaj personave fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj. Organet shtetërore kanë detyrimin për të kompensuar dëmin, *inter alia*, nëse me anë të ushtrimit të funksioneve të tyre publike, veprimet ose mosveprimet e tyre të ligjshme shkaktojnë dëm ndaj interesave të ligjshëm të personave privatë fizikë ose juridikë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës

12. Qeveria vlerësonte se kërkuessit nuk kishin shteruar në mënyrën e duhur mjetet e brendshme, sepse ata kishin kërkuar kompensim përpara gjykatave vendëse për çdo humbje financiare, apo humbje tjetër, që kishin pësuar.

13. Kërkuessit argumentuan se legjislacioni që kundërshtojë nuk parashikonte mundësitë për apelim ndaj revokimit të licencës së kompanisë kërkuese. Gjithashtu, ata argumentuan se kompensimi ishte i mundur vetëm për aktet e paligjshme administrative dhe se ndërhyrja në të drejtën e tyre për gëzimin paqësor të pasurive të tyre ishte e mbështetur në ligj, duke e bërë të pamundur që ata të kërkonin kompensim.

14. Parimet e përgjithshme për shterimin e mjeteve të brendshme përmbledhen në vendimin *Vučković dhe të Tjerë kundër Serbisë* ([DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69–77, 25 mars 2014, dhe *Gherghina kundër Rumanisë* ((vendim) [DHM], nr. 42219/07, §§ 83–89, 9 korrik 2015).

15. Gjykata vlerëson në veçanti, se nëse ekzistojnë një sërë mjeteve të brendshme në fusha të ndryshme të ligjit, që mund të ndjekë një individ, ky person ka të drejtën të zgjedhë një mjet që adreson ankesën thelbësore të tij ose të saj. Me fjalë të tjera, nëse është ndjekur një mjet, nuk është e nevojshme që të përdoret një mjet tjetër që në thelb ka të njëjtin objektiv (shih *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë* [DHM], nr. 41720/13, § 177, 25 qershor 2019). Në këtë çështje, Gjykata duhet të përcaktojë nëse, për sa i përket ankesës përpara Gjykatës Kushtetuese, legjislacioni përkatës është kushtetues dhe nëse kërkesa për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shteti përpara gjykatave të zakonshme kishte “në thelb të njëjtin objektiv”, në lidhje me ankesën e kërkuessve.

16. Gjykata vëren se qëllimi i kundërshtimit kushtetues ishte deklarimi i legjislacionit të kundërshtuar si jokushtetues, me rezultatin e dëshiruar që ky legjislacion të mos kishte asnjë ndikim. Një ankesë e tillë kushtetuese nuk mund të sillte kompensim pasuror për kërkuessit.

17. Në lidhje me padinë civile kundër shtetit për kompensimin e dëmeve, qëllimi është që të përfitohet kompensim monetar për humbjet financiare, apo për çdo humbje tjetër, me të cilat mund të jenë përballur kërkuessit si rezultat i legjislacionit të kundërshtuar.

18. Rezulton se këto dy mjete nuk kanë të njëjtin qëllim, dhe tashmë Gjykatës i duhet të vlerësojë nëse pretendimi për dëmshpërblim mund të konsiderohet si një mjet efektiv për shkëlqen e pretenduar sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

19. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata sjell në vëmendje, se deri më tani ajo ka gjykuar një sërë çështjesh që kanë lidhje me revokimin e licencave për të kryer një aktivitet biznesi dhe se mundësia për përfitim të kompensimit është një vlerësim i zakonshëm në këto raste, duke përfshirë situatat kur heqja e licencës është rezultat i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes legjislative (shih, për shembull, *Pinnacle Meat Processors Company dhe 8 të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 33298/96, 21 tetor 1998; *Ian Edgar (Liverpool) Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 37683/97, GJEDNJ 2000-I; *Findlater kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 38881/97, 26 shtator 2000; *Vékony kundër Hungarisë*, nr. 65681/13, §§ 24 dhe 35, 13 janar 2015; *S.C. Antares Transport S.A. dhe S.C. Transroby S.R.L. kundër Rumanisë*, nr. 27227/08, § 49, 15 dhjetor 2015; *Werra Naturstein GmbH & Co KG kundër Gjermanisë*, nr. 32377/12, §§ 29–33, 19 janar 2017; *Svit Rozvaz, TOV dhe të Tjerë kundër Ukrainës*, nr. 13290/11 dhe 2

të tjerë, §§ 18 dhe 154, 27 qershor 2019; dhe *NIT S.R.L. kundër Republikës së Moldovisë* [DHM], nr. 28470/12, § 254, 5 prill 2022).

20. Nuk ka dyshime se masa për të cilën ankohen kërkuesit ishte e ligjshme. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese gjykon se ajo ndoqi qëllimin legjitim për të mbrojtur interesat publikë (shih paragrafin 5 më sipër), dhe Gjykata nuk ka arsye që të dyshojë për atë përfundim. Në këto rrethana, një mjet kompensues, më konkretisht mundësia që kërkuesit të kërkojnë kompensim për çdo dëm që mund të kenë vuajtur, për shkak të zbatimit të legjislacionit të kundërshtuar, do të kishte qenë i mjaftueshëm (*krahaso Vangelova dhe të Tjerë kundër Maqedonisë së Veriut* (vendim) [Komiteti], nr. 17218/17, § 11, 17 maj 2022).

21. Megjithatë, kërkuesit nuk depozituan kurrë një kërkesë për kompensimin e dëmeve që mund të kenë vuajtur, për shkak të legjislacionit konkret. Një pretendim i tillë do të kishte qenë i mundur, në parim, në mbështetje të ligjit nr. 8510 ose të Kodit Civil (shih paragrafët 10–11 më sipër).

22. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se kërkuesit paraqitën faktikisht përpara saj një kërkesë, *inter alia*, për dëmet pasurore. Megjithatë, fillimisht u takon gjykatave vendëse që të vlerësojnë faktet e një çështjeje, dhe Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së parë.

23. Gjykata vëren se sipas nenit 122 të Kushtetutës së Shqipërisë çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën një pjesë të sistemit juridik të brendshëm (pasi publikohet në Fletoren Zyrtare), në parim është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ka prioritet kundrejt ligjeve të vendit që nuk përputhen me të. Sipas nenit 17 § 2 të Kushtetutës, kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese: “nuk mund të tejkalojnë në asnjë rast kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

24. Në këtë mënyrë, Gjykata është një pjesë integrale e sistemit juridik të Shqipërisë, ku ajo ka përparësi kundrejt dispozitave statutores kundërshtuese dhe është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për këtë arsye, u takon kërkuesve në çështjen konkrete që të argumentojnë përpara autoriteteve vendëse se në rrethanat e kësaj çështjeje, janë shkelur të drejtat e tyre, sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 (shih edhe *Shpata kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore*, Gjykata e Lartë e Shqipërisë, vendim i datës 22 korrik 2021, ku Gjykata e Lartë zbatoi në mënyrë të drejtpërdrejtë nenin 6 të Konventës, në mbështetje të çështjes *Dauti kundër Shqipërisë*, nr. 19206/05, 3 shkurt 2009). Autoritetet vendëse do të kishin pasur mundësinë t’u përgjigjeshin këtyre argumenteve dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 19 mars 2008 nuk i gjykoi këto pretendime si të pavlefshme për qëllimet e çështjes në fjalë.

25. Nëse kërkuesit do ta kishin depozituar këtë padi të brendshme, ata do t’u kishin dhënë gjykatave vendëse mundësinë për të cilin është hartuar rregulla e shterimit të mjeteve të brendshme, më konkretisht për të përcaktuar çështjen e përputhshmërisë së masave vendëse që binin në kundërshtim me Konventën, dhe nëse kërkuesit do t’i kishin paraqitur ankesat e tyre përpara Gjykatës, ajo do të kishte marrë edhe gjykimet e gjykatave vendëse (shih *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 13378/05, § 42, GJEDNJ 2008, dhe, *mutatis mutandis*, *Saygılı dhe Karataş kundër Turqisë*, nr. 6875/05, § 36, 16 janar 2018).

26. Në këtë mënyrë, kërkuesit nuk morën hapat e duhur për t’u bërë të mundur gjykatave vendëse që të përmbushnin rolin e tyre themelor në sistemin për mbrojtjen e Konventës, ku roli i Gjykatës Evropiane vinte pas tyre (shih, midis autoriteteve të tjerë, *Vučković*, cituar më sipër, § 90). Gjykata nuk gjen as ndonjë arsye të veçantë për përjashtimin e kërkuesve nga kërkesa për shterimin e mjeteve vendëse, në përputhje me rregullat e zbatueshme dhe procedura e ligjit vendës.

27. Në lidhje me dyshimet e kërkuesve për mundësinë e suksesit të mjetit në fjalë, Gjykata ka theksuar se ekzistenca e dyshimeve për suksesin e një mjeti të caktuar që nuk është qartazi i pavlefshëm, nuk është arsye e vlefshme për mosshterimin e këtij mjeti (shih *Vučković dhe të Tjerë*, cituar më sipër, § 74).

28. Sipas rrethanave, kjo ankesë duhet të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve vendëse.

B. Neni 13 i Konventës

29. Gjykata vëren në fillim se ishte e mundur që legjislacioni në fjalë të kundërshtojë me anë të një ankese kushtetuese, dhe se, në të vërtetë, Gjykata Kushtetuese parashikonte arsye të detajuara për vlerësimin e kushtetueshmërisë së legjislacionit të kundërshtuar. Në vijim, legjislacioni vendës jep mundësinë për të kërkuar dëmshpërblim ndaj shtetit (shih paragrafin 11 më sipër).

30. Në këtë mënyrë, kërkuarit kishin mundësinë të adresonin thelbin e ankesave të tyre, në lidhje me efektet e legjislacionit të kundërshtuar për aktivitetin e biznesit të tyre përpara gjykatave vendëse.

31. Rrjedhimisht, ankesa në mbështetje të nenit 13 të Konventës është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 11 prill 2024.

Olga Chernishova
ZËVENDESESSEKRETARE

Georgios A. Serghides
KRYETAR